



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Prezantimi nga ministri i Financave dhe Ekonominë i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike.

Mungojnë:

Agron Shehaj dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Alba Caroshi – këshilltare e Ministrinë së Ekonomisë dhe Financave

Arbër Lleshi – këshilltar i Ministrinë së Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Sot në rendin e ditës së këtij komisioni është prezantimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Relatore e komisionit lidhur me këtë projektligj është zonja Blerina Gjylameti. Për të prezantuar projektligjin, i pranishëm në Komisionin e Ekonomisë është ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj.

Fillojmë me prezantimin e projektligjit nga zoti Ahmetaj, pastaj me relatorin e komisionit.

Sot do të bëjmë seancën e pyetjeve dhe përgjigjeve dhe, natyrisht, diskutimin në parim të këtij projektligji.

Po, zonja Tabaku!

Jorida Tabaku – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, sot i vetmi rend dite në këtë komision duhet të ishte çështja e Teatrit Kombëtar. Në parlamentin e Shqipërisë kaloi me procedurë të përsheptuar, në mënyrë antikushtetuese dhe antiligjore, projektligji i qeverisë shqiptare, i cili është bashkëfirmosur nga ministrja e Kulturës dhe nga zëvendësministri i Ekonomisë dhe Financave. Meqenëse zoti Ahmetaj është sot këtu, ai duhet të fliste vetëm për këtë ligj dhe asgjë tjetër. Asgjë tjetër nuk ka rëndësi! Sigurisht që opozita e ka ngritur këtë çështje dy muajt e fundit, ashtu siç ngriti edhe çështjen Xhafaj, edhe çështjen e integritit. Ne nuk jemi orakuj dhe parashikojmë çdo gjë, por çdo diskutim që ne kemi bërë në këtë komision ka dalë dhe ka rezultuar i vërtetë. Për pothuajse 1 muaj e gjysmë kemi ngritur çështjen e ministrit të Brendshëm dhe çështjen e pastrimit të parave, i cili u reflektua në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit dhe si rezultat pati këtë kurs të këmbimit të euros, që sot shqiptarët, pensionistët, emigrantët dhe bizneset po e vuajnë, por Komisioni i Ekonomisë nuk pati mundësi ta diskutonte këtë, sepse kjo është hera e parë, pas 6 muajsh, që ministri vjen në Komision. Kemi ngritur shqetësimin për rritjen e vazhdueshme të taksave, të taksës së pronës dhe çdo gjë që ne deklaruar këtu rezultoi e vërtetë. Në fakt, sot ka një kolaps të jashtëzakonshëm në sistemin e taksave, pasi, 5 vjetësh, kur qeveria i ka rritur taksat me pothuajse 5 miliardë euro, nuk gjen dot 30 milionë euro për ndërtesën e Teatrit Kombëtar. Sot prona publike po falet, po grabitet, po i jepet privatit, ndërkohë që prona private e qytetarëve të thjeshtë të Tiranës nuk ndërtohet dot, por rrënohet. Vetëm klientët e qeverisë mund të ndërtojnë, vetëm klientët e qeverisë marrin tender, vetëm klientët e qeverisë marrin koncesione. Pasi qeveria i rriti taksat me 5 miliardë

euro, nuk gjen dot para për një teatër 30 milionë euro, por detyrohet ta rrafshojë atë, një nga ndërtesat e vetme historike të mbetura të qytetit. Pastaj do të vazhdojë me Galerinë e Arteve, do të vazhdojë me ndërtesa të tjera historike të qytetit, ashtu siç filloi me stadiumin kombëtar dhe jam e sigurt që këtij qyteti nuk do t'i mbetet më asgjë.

Fatmirësisht protesta qytetare, e mbështetur edhe nga Partia Demokratike, ka pasur rezultat. Fatmirësisht ka qytetarë të ndërgjegjshëm të këtij vendi që duan t'i thonë: ndal korrupsionit dhe vjedhjes galopante që po bëhet me Tetarin Kombëtar.

Unë jam e sigurt se çfarëdo që të themi ne sot këtu ju do të vazhdoni t'i ngrini kartonët. Jam e sigurt se ky ligj që ka ardhur sot në parlament bëhet për një dhe vetëm një gjë të vetëm, për të mbrojtur Erion Veliajn, kryetarin e bashkisë. Unë nuk e di se si ministrat marrin përsipër të firmosin një ligj vetëm për të mbrojtur kryetarin e bashkisë, i cili do ta bëjë këtë aferë, sigurisht edhe në emër të Kryeministrit, por që ka frikë dhe, përdor një parlament të tërë si zyrë tenderësh dhe koncesionesh për një vjedhje galopante dhe për një vjedhje të pakrahasueshme në këto vitet e fundit.

Afera me Teatrin Kombëtar, grabitja e pronës, fakti që nuk po bëhet një tender ndërkombëtar, nuk po bëhet një konkurs i hapur ndërkombëtar, por një firmë paraqet një propozim dhe ngrihet një shtet i tërë në këmbë, sigurisht që në çdo vend tjetër do të kishin vënë kampanat e alarmit, por jo këtu në Shqipëri. Pas urdhrit politik, e gjithë qeveria bëhet mburojë dhe i gjithë parlamenti bëhet mburojë.

Strategjia e zgjerimit, që publikoi Komisioni European, duhej të kishte shërbyer si udhërrëfyes për qeverinë. Strategjia e zgjerimit në mënyrë të qartë thotë: "Oligarkët janë duke marrë çdo tender: oligarkët, të ndërthurur me interesat publike të atyre që sot qeverisin Shqipërinë, janë duke zaptuar çdo gjë, troje publike, duke marrë tenderë dhe koncesione, por prapë për qeverinë kjo nuk është kampanë alarmi". Përveç krimit, drogës dhe korrupsionit, kjo ishte një nga arsyet që nuk u hapën negociatat.

Këto shqetësime i kemi ngritur ne, i ka ngritur edhe Komisioni European, por, fatkeqësisht, sot ndodhemi në situatën, ku qeveria është duke përkeqësuar çdo gjë që ishte arritur në procesin e integritetit. Kjo është e vetmja qeveri që mori 5 kritere dhe i çoi në 13 kritere dhe një ndër to është edhe korrupsioni që bëhet me pronën publike, me tenderët dhe me koncesionet. Po ju jap disa shembuj të korrupsionit, 500 milionë euro u harxhuan për qendrat e qyteteve, për të bojatisur qendra bosh qytetesh, pasi sot shqiptarët janë larguar; 157 mijë shqiptarë kanë aplikuar për azil në vendet e Europës; sot janë harxhuar pa fund për luks, për ndërtesa të reja, për rregullim zyrash të qeverisjes dhe për të blerë makina, por për Tetarin Kombëtar nuk shpenzohen dot 30 milionë euro. Qeveria, po të dojë, i gjen këto para, por ka

zgjedhur të mos i gjejë dhe ka zgjedhur që me një aferë korruptive të na vejë para një ligj të paprecedent. Në fakt, këtu kanë ardhur edhe ligje të tilla: ka ardhur ligji për portin e Karpenit, që ne e denoncuam dhe që sot, pas 4 vjetësh, është një fluskë sapuni, pasi asgjë nuk po ndodh; ka ardhur ligji për Rrugën e Arbërit, që ne e denoncuam dhe, asgjë nuk ndodhi, dhe ky është ligji i tretë që vjen në këtë mënyrë, pas ligjit për aeroportin e Vlorës, që jam e sigurt se do të ketë të njëjtin fat, siç patën dy ligjet e para.

Ne këtu mund të diskutojmë dhe të debatojmë për shumë gjëra, por e shkruar e zeza mbi të bardhë është ky projektligj, i depozituar në parlament ditën e enjte, që është afera më e madhe që parlamenti me votat e deputetëve socialistë po përpiqet të mbulojë, pasi votat tona nuk do t'i ketë.

Kam dëgjuar shumë këto ditë, kam dëgjuar sulme nga kryetari i bashkisë Erion Veliaj, sepse ai është mjeshtër për të sulmuar ata që nuk kanë të njëjtin mendim me të, ashtu siç po bën edhe qeveria kohët e fundit. Njerëzit që nuk shkojnë në teatër flasin dhe jo ata që shkojnë në teatër, ashtu siç flisnin ata që nuk shkonin në stadium.

Qeveria më e arsimuar dhe më e mira e të gjitha kohërave përmbysi edhe Bibliotekën Kombëtare, që do t'i vërë flakën asaj dhe të gjitha institucioneve të tjera që kanë mbetur në këtë vend. Unë e di që nuk ju intereson fare, por ka ca njerëz që u intereson identiteti i qytetit, identiteti i Tiranës, asetet publike, pronat publike dhe Tetari, që nuk është një lokal, por aset kombëtar.

Unë do të doja që në Komisionin e Ekonomisë ne të kishim bërë një diskutim të thelluar për këtë çështje, por, fatkeqësisht, parlamenti vendosi që këtë çështje të mos ia kalojë Komisionit të Ekonomisë, megjithëse është një ligj që ka lidhje me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

Ashtu siç ne kemi paralajmëruar, me këtë aferë do të vazhdojë pastrimi i parave, ashtu siç po ndodh me pikat e basteve, ashtu siç po ndodh në sektorin e ndërtimit, ashtu siç po ndodh në sektorin e hoteleri-turizmit, pra të gjitha janë çështje që ne i kemi paralajmëruar, por sigurisht kanë shkuar në vesh të shurdhët.

Me këtë ligj, që ka ardhur sot këtu, shkelet Kushtetuta e vendit dhe ligji për pushtetin lokal, sepse duhet të kalonte në këshillin bashkiak me 3/5-at e votave të këshilltarëve, por e dinë që s'i kanë; shkelet ligji i koncesioneve dhe çdo ligj që ka lidhje me pronën publike dhe me asetet publike. E di që për ju asgjë s'ka vlerë, e di që për ju asgjë nuk ka rëndësi para aferës së madhe të shembjes së Teatrit dhe të ngritjes së kullave me paratë e drogës dhe të krimit.

Muajt e fundit në këtë komision, kemi duke dëgjuar vetëm raportime të institucioneve të pavarura; në parlament ne kemi diskutuar vetëm raportime të institucioneve të pavarura. Ka muaj që qeveria nuk funksionon, ka muaj që qeveria nuk prodhon asgjë, përveç marrëveshjeve ndërkombëtare, që shtyhen, dhe përveç institucioneve të pavarura që raportojnë në komisione dhe në parlament. Qeveria nuk prodhon asgjë, por gjeti kohën të nxjerrë nga sirtarët e saj një ligj, që, sigurisht, duket nuk është shkruar nga institucionet e qeverisë shqiptare, por është shkruar nga një biznes privat dhe kjo është gjëja më e turpshme, që bizneset private sot po hartojnë ligje, që vijnë deri në parlament, i mbron me votën tuaj dhe vijnë këtu me firma zëvendësministrash, se ministrat kanë frikë ta firmosin, që kryetari i bashkisë ka frikë ta firmosë vetë, edhe ai me firmë zëvendëskryetari i nis të gjitha dokumentet. Në fakt, kjo praktikë ka nisur në vitin 2002 në Bashkinë e Tiranës, që vazhdon sot, dhe njëkohësisht, është praktikë edhe në qeverinë shqiptare, nuk firmos Kryeministri, firmos zëvendëskryeministrja; nuk firmosin ministrat, firmosin zëvendësministrat, sepse këtë aferë, kushdo që e firmos, e di që nesër do të shkojë për t'u hetuar në prokurori, e di që nesër e ka vendin atje ku duhet ta ketë kushdo që shkel ligjin, kushdo që vjedh pronën publike, kushdo që bën korrupsion.

Unë do të kisha dashur që këto çështje të kishin qenë në rendin e ditës, asgjë tjetër nuk ka rëndësi, përveç kësaj, në këtë moment; do të kisha dashur që të gjithë, të majtë dhe të djathtë, të diskutonim për këtë çështje me interes kombëtar. E di që nuk mund ta pres këtë, e di që do të jetë e pamundur që të diskutojmë këtu me argumente, por të paktën duhet të kemi minimumin e interesit kombëtar para sysh, kur diskutojmë këtë ligj dhe ligje të tjera, që lidhen me prishjen e Teatrit Kombëtar. Për këtë arsye, përsëris kërkesën që përsëritëm sot në Komisionin e Ligjeve: tërhiqeni ligjin, se nuk është vonë, mos u bëni palë me vjedhjen dhe me korrupsionin që po ndodh me pronën publike në Teatrin Kombëtar, me të gjitha asetet publike, me tenderët dhe koncesionet; mos u bëni palë me pastrimin e parave të krimit dhe të drogës. Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Tabaku, thatë shumë gjëra, dhe, me thënë të drejtën, meqenëse jemi në këtë vaktin e Rusisë, përsëri si sallatë ruse u bë. Mua më vjen keq, por dua t'ju them se ligji që kemi përpara, nuk është ligji për të cilin flisni ju. Ligji që keni përpara është ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Mendoj se ky ligj, i cili ul tatimin mbi fitimin për mbi 80 mijë biznese, duke e bërë nga 15% në 5%, është interes shumë i fortë kombëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky ligj që bën tatimfitimin 5% për të gjitha shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe blegtoral, është interes shumë i fortë kombëtar. Ky ligj që bën tatimfitimin 5% për të gjithë

subjektet, sipërmarrjet që do të merren me agroturizëm, është interes shumë i fortë kombëtar. Natyrisht, ky ligj që bën 15% tatimfitimin për të gjithë lojërat e fatit, përfshirë edhe bastet, pa asnjë lloj diskutimi është një interes shumë i fortë kombëtar. Ne për këtë ligj kemi ardhur. Për këtë ligj ndodhet në Komisionin e Ekonomisë edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave. Ligji për të cilin ju flisni, pa asnjë lloj diskutimi, fillon për punë minutash, të diskutohet në dy komisione të tjera, që nuk kanë lidhje me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, pra është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese dhe Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Tek ato mund të diskutoni pa asnjë lloj problemi të gjithë elementet për të cilat folët këtu, madje kam edhe disa të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, edhe mua do më pëlqente që ky ligj të diskutohej këtu, në Komisionin e Ekonomisë, por nuk e vendos unë, vendos Kuvendi i Republikës së Shqipërisë se çfarë ligji kalon.

Zoti deputet, mund të zhvendoseni këtej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ministër, këtë mbledhje e drejtoj unë, po të doni mund ta shoqëroni! Pra, po thosha se, pa asnjë lloj diskutimi, ky komision ta kishte diskutuar këtë çështje, por për këtë gjë vendos parlamenti, nuk vendosim ne, nuk vendos unë dhe nuk vendos as ky komision. Cilido nga deputetët, praktik që na e keni mësuar juve, që është një interesuar për një ligj të caktuar, sipas Rregullores së Kuvendit, mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisionit, të diskutojë pa asnjë lloj diskutimi të marrë informacione plus, të sqarohet deri në fund, i mungon thjesht e drejta e votës në atë komision, në seancë plenare që të gjithë kanë të drejtën e votës. Kështu që do të ishte krejt normale, që të gjithë çfarë thatë këtu për një ligj të caktuar, ta kishit bërë në komisionet respektive.

Së dyti, sepse po përsëritet shumë shpesh akuza për punën e komisionit apo për mënyrën se si funksion komisioni e të tjera me radhë. Komisioni ka funksionuar në mënyrë të qartë, edhe këto 6 muaj, në bazë të Rregullores së Kuvendit dhe në bazë të kalendarit të punës së miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Po, është e vërtetë, kemi bërë dëgjesa, madje ka ndodhur që kemi thirrur institucionet edhe 4 herë, edhe 5 herë për t'iu përgjigjur deri pyetjes së fundit. Për fat të keq, ju nuk keni qenë për fat të keq, ju nuk keni marrë pjesë; për fat të keq, ju nuk keni qenë të interesuar, pikërisht, për këtë gjë. Mendoj se ky komision ka zhvilluar seanca dëgjimore me të gjitha institucionet që varen nga Kuvendi, nga ky komision respektiv, shumë serioze dhe ka prodhuar dokumente po kaq serioze, të

cilat tashmë janë dokumente të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Thënë këtë, pa asnjë lloj diskutimi, kjo puna e vlerësimit të lekut ka qenë një çështje shumë e rëndësishme...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëri, të mbaroj unë! A ka mundësi të mbaroj unë?! Bëj durim, 20 minuta foli zonja, nuk i ndërhyri kurrkush! Bëj durim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, zotëri, në qoftë se ke ardhur për mbledhje, në rregull, në qoftë se nuk ke ardhur për mbledhje, mund të vazhdosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ty, po flas. Ore, zotëri, edhe një herë, në qoftë se ke ardhur për mbledhje, në rregull, në qoftë se nuk ke ardhur për mbledhje, dil jashtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti vjen këtu dhe e merr fjalën kur ta jap unë. Edhe një herë tjetër e merr fjalën, kur ta jap unë.

Bardh Spahia – Vazhdo sqaro vjedhjen që po bëhet.

Erion Braçe – Për çfarë vjedhje flet?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku di gjë ti! Ti nuk di asgjë, nuk merr vesh nga kjo punë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti nuk di asgjë, nuk ke lidhje fare me këtë pjesë, por shko në Komisionin e Shëndetësisë bëj ndonjë punë atje. Të lutem, shko atje, sepse nuk merr vesh nga kjo punë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërpritet mbledhja dhe zotëria del përjashta. Derisa të dalë zotëria përjashta, nuk ka mbledhje. Zotëria të dalë përjashta për fyerje!

(Pas ndërprerjes)

Erion Braçe - Do t'i lutesha shumë deputetit që fyeu në këtë mbledhje komisioni, të largohet nga salla e mbledhjes!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka për procedurë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk mund të vazhdojë mbledhja duke vazhduar të rrijë deputeti që fyeu në këtë sallë.

Edmond Spaho – Zoti Braçe,

Nuk jeni ju që vendosni se cilët deputetë duhet të marrin pjesë dhe cilët nuk duhet të marrin.

Erion Braçe - Unë e vendos ekzaktësisht që deputeti që fyeu në këtë komision, të dalë jashtë nga mbledhja...

Edmond Spaho - Është e treta herë që...

Erion Braçe - Deputeti që fyeu në këtë komision, të dalë jashtë nga mbledhja! Kaq.

Edmond Spaho – Po e fut komisionin në qorrsoak.

Erion Braçe – Zoti Spaho, edhe një herë, deputeti që fyeu në këtë komision, të dalë jashtë nga mbledhja!

Edmond Spaho – Ai nuk ka për të dalë. Ajo nuk ishte e sharë. E keni shumë gabim!

Erion Braçe - Nuk ka për të dalë?

Zoti Ministër, keni fjalën për të prezantuar projektligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Unë kam kërkuar fjalën për procedurë dhe ju nuk po ma jepni.

Arben Ahmetaj - Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, synon:

Shkallëzimin e normës së tatimit mbi fitimin. Për bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë norma e tatimit mbi fitimin propozohet 5% e fitimit para tatimit, ndërsa për bizneset me të ardhura mbi 14 milionë lekë, norma e tatimit mbi fitimin mbetet 15% e fitimit para tatimit;

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Incentivimin e fermerëve të përfshirë në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor sipas kuptimit të ligjit përkatës të fushës, duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin korporativ nga 15% në 5%;

Incentivimin e bizneseve që janë të licencuara dhe operojnë në fushën e agroturizmit, duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin korporativë, nga 15% në 5%;

Sektori i bujqësisë përbën një ndër sektorët bazë të ekonomisë shqiptare. Zhvillimi dhe modernizimi i tij do të ketë impakt edhe në sektorë të tjerë prioritarë për vendin, sikurse është industria e turizmit, e cila e ka të nevojshme bashkëpunimin me një sistem bujqësor, që është në gjendje të garantojë furnizimin me produkte bujqësore dhe blegtorale në sasi, cilësi dhe kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë, një sektor bujqësor i kompozuar nga fermerë individualë me ngastra të vogla toke dhe prodhim minimal për treg, nuk është në gjendje të plotësojë kërkesat e konsumatorëve dhe, për më tepër, ato të një industrie siç është turizmi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithashtu, është e vështirë që prodhuesit individualë të jenë faktor i rëndësishëm për rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këto arsye, është e domosdoshme që të rritet shkalla e kooperimit në bujqësi, një ndër format e të cilës janë shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor të parashikuara me ligj. Nxitja e kooperimit të fermerëve dhe krijimi i këtyre shoqërive kërkon edhe stimuj nxitës, pasi në të kundërt nuk do të rritet interesi për kooperim nga fermerët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë kuptim, krahas masave të tjera nxitëse të sektorit bujqësor, sikurse janë subvencionet, investimet në kullim, ujë etj., është e arsyeshme që nxitjes së kooperimit dhe krijimit të njësive të mëdha prodhuese bujqësore t'i shërbejë edhe një normë tatimi mbi fitimin e reduktuar për këto shoqëri.

Në kuadrin e mbështetjes dhe stimulimit të sektorëve dhe industrive prioritare të vendit sektori i agroturizmit do të jetë gjithashtu një ndër prioritetet e vendit, me qëllim zhvillimin e turizmit në zonat rurale. Pra, po krijojmë një balancë midis spektrit të strukturave akomoduese me 4 dhe me 5 yje, që bëmë në vjeshtë me pjesën tjetër të agroturizmit, që do të shërbejë kryesisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Iniciativa e ndërmarrë synon të nxisë krijimin dhe rritjen e këtij biznesi, i cili pritet të ofrojë akomodim, ushqim, çlodhje, argëtim dhe veprimtari të tjera të lidhura me fermën bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga 1 prilli 2018, pragu i regjistrimit për TVSH-në pësoi ulje me 5 milionë lekë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... shërbime shëndetësore dhe arsimore.

Nga ana tjetër, bizneset e vogla...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulja e pragut të TVSH-së synon...

(deputeti Noka dhe ministri Ahmetaj flasin njëkohësisht)

Flamur Noka – ... Shqiptarët kanë nevojë të dinë nëse janë hapur apo jo negociatat dhe pse ju i mashtroni ...

(deputeti Noka dhe ministri Ahmetaj flasin njëkohësisht)

Arben Ahmetaj - ... përcakton ndryshimin e skemës së tatimit të investitorit dhe pronarit të truallit në ndërtim, në të gjitha rastet, kur trualli transferohet nga pronari i tokës, sipas një kontrate këmbimi të tokës me sipërfaqe ndërtimi ...

(Deputeti Noka dhe ministri Ahmetaj flasin njëkohësisht.)

Flamur Noka – ...si e keni gjetur skemën? Kulla, kulla dhe vetëm kulla për të pastruar paratë që sillen me Toyota, me trajlerë dhe mënyra të tjera; për të pastruar paratë që bandat që ju mbështesni...

Arben Ahmetaj – Ky ndryshim ligjor jo vetëm që do të harmonizonte të drejtën e taksimit të shoqërisë dhe pronarit të truallit, duke kërkuar nga secili prej tyre 15% të fitimit real që realizojnë, por njëkohësisht vjen si një ndryshim në koherencë me ngritjen e kadastrës fiskale, ku çdo pronë do të ketë edhe vlerën fiskale të regjistrimit dhe taksimit të drejtë të saj.

Flamur Noka – Sipas Bankës së Shqipërisë po bëjnë pastrimin e parave dhe të krimit tuaj qeveritar, të Kryeministrit. Ky vend, ndërkohë që ju kakarisni aty është bërë vend i pajetueshëm për shqiptarët. A e dini se keni përzënë në pesë vjet 500 mijë shqiptarë nga ky vend? Ju derrat e majmur, që nuk doni t’ia dini për varfërinë e shqiptarëve?!

Arben Ahmetaj – Ndërkohë, është hartuar edhe udhëzimi i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, dhe i ministrit të Drejtësisë, me qëllim saktësimin e procedurës dhe bazës së taksës për individët, në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ku përfshihet edhe shitja e pasurive të paluajtshme ndërtesa, të përfituara nga një kontratë këmbimi truall/ndërtesë.

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Flamur Noka –A e dini se 1,3 milionë shqiptarë në këto vite kanë aplikuar për Lotarinë Amerikane, sepse ua keni bërë të pamundur jetesën në këtë vend?

Arben Ahmetaj – Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” synon incentivimin dhe zhvillimin veprimtarive pritëse të certifikuara si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, nëpërmjet aplikimit të shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6%.

Flamur Noka – Nuk ka si ju asnjë qeveri në botë, që të bëjë, në fund të fundit, edhe një ligj për të vjedhur. Çfarë është ligji “Fusha”? Ai është akti i fundit i marrëzisë së kësaj qeverie. Më thoni një vend ku, pasi qeveria ka vjedhur pafund pesë vjet rresht dhe nuk është

ngopur, bën edhe një ligj për të justifikuar vjedhjen? Kjo bëhet për t'u vjedhur tokën qytetarëve të Tiranës.

E morët këtë vend në kushte krejt normale dhe e keni katandisur më keq se Afganistani. Shqipëria, për sa u përket vrasjeve mafioze, po kthehet më keq se Meksika, sepse pazaret e drogës e kanë kthyer këtë vend në të rrezikshëm.

Vrasja e shoferit të ministrit të Brendshëm është sinjal i qartë i pazareve të prishura të kësaj qeverie dhe të bandave të saj, ndaj nuk mund të ketë sot çështje tjetër në rend dite për shqiptarët, përveçse të shporren këta banditë që na qeverisin! Të shporren këta banditë, që u kanë pirë gjakun shqiptarëve! Të shporren këta banditë e zuzarë, që u kanë vjedhur deri në qindarkën e fundit shqiptarëve dhe i kanë katandisur shqiptarët të duken të rrjepur dhe të masakruar në vendin e tyre!

Ndërkohë që këta banditë e kanë katandisur vendin e tyre më keq sesa vendet e Botës së Tretë, për vete harxhojnë miliona euro, çfarë i kushtonte kësaj qeverie që ato 30 milionë euro që vjedh Kryeministri t'i ndante mënjane dhe të ndërtonte Teatrin?!

(Deputeti Noka dhe ministri Ahmetaj flasin njëkohësisht.)

Po si keni fytyrë t'u thoni shqiptarëve se ju nuk paskeni para për të ndërtuar rrugë? Para për të ndërtuar ujësjellës nuk keni! Para për të ndërtuar shkolla nuk keni! Para për bujqësinë nuk keni! Ku i keni paratë, që mbledhni nga taksat e qytetarëve? Të gjitha për të rrjepur shqiptarët. Ku i çuat paratë? Ku po i gjeni ju paratë, zotërinj, për të ndërtuar rrugë, për të ndërtuar Piramidën (muzeun e Enver Hoxhës)?

Teatri është me ne. Ato para që ju i çoni për Piramidën, çojini për Teatrin dhe do ta shihni se do të quhet një gjest pozitiv, do të jetë një shenjë pozitive. Por jo, se ju jeni të babëzitur.

Arben Ahmetaj – Në kuadrin e mbështetjes dhe stimulimit të sektorit të agroturizmit parashikohet përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë...

Flamur Noka – Është e turpshme! Mos mendoni se po bëni një ligj, që quhet ligji “Fusha”; mos mendoni se me këtë ligj do të mund t'ia kaloni kollaj kësaj situatë. Ka vetëm një zgjidhje për ju pastaj: burgu!

Edhe pse po bëni ligj për të vjedhur me ligj, burgu do të jetë fundi juaj, fundi i kësaj qeverie, sepse kjo qeveri nuk ka asnjë ndjeshmëri për shqiptarët! Se po të kishte ndjeshmëri për shqiptarët, në pesë vjet do të kishte bërë ndonjë investim për këtë vend, jo vetëm për fasadat që ka qejf Edi Rama. Do ta kishte bërë ndonjë shkollë, por jo...

U bënë pesë buxhete që vetëm vidhen dhe vidhen, dhe tani i jeni turrur edhe pronës publike. Ku ka bërë vaki të bësh një ligj nga qeveria për të vjedhur pronën publike? Ku ka bërë vaki në ndonjë vend të Europës të ketë një qeveri kaq mashtruese?

Maqedonia deklaron hapur, se nuk iu hapën negociatat. Vjen këtu lideri global dhe thotë se u hapën negociatat! Mashtron shqiptarët!

Por dua të them një gjë tjetër.

(Deputeti Noka dhe ministri Ahmetaj flasin njëkohësisht.)

Arben Ahmetaj – ...e ndërtimeve që bëhen me qëllimagroturizmin nga personat e pajisur me certifikatë për veprimtari agroturistike. Në këtë mënyrë, biznesi i agroturizmit stimulohet me të njëjtat instrumente që u përdorën për stimulimin e turizmit elitare me pesë yje. Lidhur me deklaratën e fundit...

Ekonomia në tremujorin e parë të vitit 2018 u nis me 4,45%. Rritje ekonomike...

(Deputeti Noka dhe ministri Ahmetaj flasin njëkohësisht)

Faleminderit për vëmendjen spektakolare!

Flamur Noka – Mirë që është Kryeministri i një vendi kaq të vogël dhe po mashtron vetëm shqiptarët, se, imagjinoni, ta kishit global këtë ju dhe të ishte Kryeministri i Gjermanisë apo i Francës, do të kishte marrë më qafë...

Mos e mbyll mikrofonin!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Fjalën e ka relatorja, zonja Blerina Gjylameti.

(Deputetja Gjylameti flet pa mikrofon.)

Blerina Gjylameti – ...ekonomisë shqiptare.

Flamur Noka – Mos e mbyll mikrofonin!

Ndaj po ju them se fundi i babëzisë tuaj është i hapur. E keni deklaruar këtu e kohë të shkuara, që deri më 28 qershor ne do të bëjmë gjithçka për të hapur negociatat, por pas datës 28 marrëdhënia me ju do të ndryshojë. Pse? Sepse shqiptarët nuk mund ta durojnë më pengmarrjen nga ju, pengmarrjen nga Kryeministri juaj!

Shqipëria sot është e marrë peng nga një kryehorr, që, megjithëse i përplasi derën në serrat Europa, del dhe i mashtron shqiptarët me pafytyrësinë që e karakterizon dhe u thotë shqiptarëve se do të hapen negociatat!

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Blerina Gjylameti – Paketa e re fiskale që na paraqitet tregon angazhimin e qeverisë shqiptare për të siguruar mbështetjen e vazhdueshme për sipërmarrjen dhe garantimin e rritjes së qëndrueshme të tyre që në fund prodhon punësim.

Projektligjet financiare paraqesin në mënyrë të qartë dhe të detajuar politikat tatimore, që do të ndiqen nga 1 janari 2019, si në drejtim të zgjerimit të të ardhurave tatimore, që bazohen në taksimin e ndershëm, ashtu edhe në uljen e informalitetit, duke synuar në të njëjtën kohë nxitjen e investimeve private, strategjike në sektorët prioritarë.

Flamur Noka – Ndërkohë në Maqedoni...

Blerina Gjylameti – Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” parashikon ndryshimin e 5 neneve ekzistuese të ligjit. Këto ndryshime janë konsultuar në shkallë të gjerë edhe me grupet e interesit dhe shoqatat e bizneseve në vend. Ato propozojnë lehtësira fiskale të qenësishme për zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë shqiptare, siç janë bujqësia dhe turizmi, të cilët në vizionin e qeverisë shihen si sektorë, që do të garantojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim, nxitje të ndërmarrjeve të vogla e të mëdha, më shumë të ardhura e më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë.

Flamur Noka – ...askush nuk thotë që hapen negociatat. Ata deklarojnë zyrtarisht se Maqedonisë dhe Shqipërisë nuk iu hapën negociatat. Por me një ndryshim, Maqedonisë iu vu kusht reforma në drejtësi dhe përparimi... Shqipërisë iu vunë 8 kushte. Iu renditën 13 kushte të reja, gjë që nuk ka bërë vaki asnjëherë, që një vendi detyrim për të ecur përpara t’i përcaktohen kushtet dhe pastaj t’i shtohen 13 kushte të tjera. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se ky vend nuk ka hedhur asnjë hap për rrugën e duhur drejt Europës.

Kjo do të thotë se ky vend nga pesë kushte, iu bënë 13, sepse ky vend ka pasur vetëm regres. Por normalisht regres, sepse qeverisemi nga trafiku! Normalisht regres, sepse qeverisemi nga trafikantë! Normalisht regres, sepse qeverisemi nga hajdutë! Normalisht regres, sepse qeverisemi nga njerëz, të cilët nuk duan t’ia dinë për qytetarët, por mendojnë vetëm për oborrtarët dhe për bizneset e tyre.

Blerina Gjylameti – Ndryshimet e propozuara janë në vijimësi të reformave të nisura nga qeveria si programi i “Rilindjes urbane dhe rurale”, për të cilin deri në vitin 2017 janë rikonstruktuar rreth 300 mijë metër rrugë, rreth 20 mijë metra bulevarde dhe shëtitore, rreth 200 mijë m2 sheshe dhe qendra urbane, si dhe qendra historike, rreth 150 mijë m2 parqe, nga kanë përfituar mbi 1,8 milionë shqiptarë dhe rreth 3 mijë biznese, të cilat ushtrojnë aktivitetin në zonat e transformuara prej tyre apo programi i 100 fshatrave dhe krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar...

Flamur Noka – Ndaj po ju them: ndaleni këtë lloj maskarade!

Blerina Gjylameti – ...që synon të krijojë për herë të parë modelin e suksesit në zhvillimin e integruar rural të vendit, sipas standardeve më të mira europiane. Qasja e

integruar për zhvillimin rural do të targetojë objektiva të matshëm për zhvillimin e hapësirës rurale, nëpërmjet fokusit të qendëruar (programim i integruar dhe i koordinuar) të investimeve publike, atyre të donatorëve dhe investimeve private në hapësirën e mirëpërcaktuar të 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomiko-social, agroturizmit dhe turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore.

Flamur Noka –Nuk mund të keni më marrëdhënie normale me popullin shqiptar dhe me opozitën, sikundër edhe ne me ju. Duhet t'i thërrisni mendjes! Kjo qeveri nuk do të pranohet më nga opozita. Ne nuk do të pranojmë që të fati i këtij vendi të ngelet në dorën e hajdutëve, të ngelet në dorën e banditëve! Ne nuk do të pranojmë që fati i këtij vendi të merret peng nga mashtrues ordinerë!

Ndaj po ju them: të ndalet revanshi dhe të pranohet një zgjidhje. Edi Rama nuk pranohet më nga opozita!

Blerina Gjylameti – Në mënyrë të detajuar disa nga masat konkrete të propozuara në secilin nga nenet e projektligjit konsistojnë në: rishikimin e fjalisë së parë të pikës 1 të nenit 11 “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, duke bërë harmonizimin e terminologjisë për pasurinë e paluajtshme...

Flamur Noka – Në rast se deri dje ju kemi kërkuar me dashamirësi maksimale dhe ju kemi thënë: largoni Saimir Tahirin, ndaloni kanabizimin e vendit që Shqipëria të ecë në rrugën drejt Europës, ju keni qenë mendjeshkurtër!

Në rast se deri dje ju kemi kërkuar të largoni Fatmir Xhafajn...

(Deputetët flasin njëkohësisht)

Blerina Gjylameti – ...sipas ndryshimeve të fundit të bëra në ligjin për taksat vendore.

(Deputetja Gjylameti flet njëkohësisht me deputetin Noka)

Flamur Noka – Krimi në Shqipëri nuk mund të ketë me tapi Ministrinë e Brendshme.

Në rast se deri dje ju kemi thënë që duhet të keni ndjeshmëri ndaj shqiptarëve dhe të qeverisni për ta, sot po ju themi nuk ... asgjë përveçse të largohet Edi Rama, sepse, sot, çdo qytetar i këtij vendi e di mirë, që nuk është më faji vetëm i Saimir Tahirit apo Fatmir Xhafajt, fajtori numër 1 sot është Edi Rama.

(Deputetja Gjylameti flet pa mikrofon)

Vendin nuk e kanë marr peng vetëm Saimir Tahiri, Fatmir Xhafaj apo babëzia qeveritare, por e ka marrë peng Edi Rama, ndaj sot e më pas ne nuk mund të pranojmë që kjo qeveri të vazhdojë, ne nuk mund të pranojmë që kjo qeveri të shkelë me këmbë

dinjitetin e shqiptarëve, ne nuk mund të pranojmë sot e më pas që shqiptarët të kenë mbi kokë një kryemashtrues, një trafikant, një drogaxhi. Shqiptarët meritojnë, ashtu sikurse e ka thënë Europa, të ecin në mënyrë dinjitoze drejt saj, një qeveri, që ju shërben atyre, një zgjedhje më ... për fatin e tyre ...

Ne duhet të kthejmë shpresën në këtë vend për të jetuar. A mundet t’ju jap këtë shans Edi Rama dhe qeveria e tij shqiptarëve? Shansin e pati 5 vjet, por nuk qeverisi asnjë ditë për shqiptarët. Vetëm për bandat dhe krimin e organizuar qeverisi. Pse? Sepse ata e sollën në pushtet, sepse ata e mbajtën në pushtet, sepse paratë e drogës i duheshin për të blerë votat ..., por jo për t’i qeverisur.

Ndaj sot është momenti final t’ju themi ndal, ikni, hapni rrugë si zgjedhje, në të kundërt përballja do të jetë e fortë.

Sot nuk mund të ketë më përballje me ju sepse ju nuk përfaqësoni asnjë shqiptar të ndershëm të këtij vendi. Gjysma juaj përfaqëson paratë e drogës, gjysma tjetër përfaqëson ..., sepse e vërtetuat në 5 vjet qeverisje. Reflektoni për të gjetur një zgjedhje dhe për të larguar këtë qeveri që t’u japim shansin shqiptarëve ...

(Deputeti Noka flet njëkohësisht me deputetet Gjylameti)

Blerina Gjylameti - ... të cilat do të përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi” nga 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2021.

Rishikimin e përcaktimeve të nenit 33/1 “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit”, me qëllim harmonizimin e nenit më përcaktimet e bëra në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pra duke hequr detyrimin për depozitimin e vendimit për miratimin e rezultatit vjetor e destinimin e fitimit për personin fizik si dhe vendosjen e gjobës për çdo rast të mosdepozitimit të vendimit të asamblesë së ortakëve dhe jo për çdo muaj vonesë. Riformulimin e paragrafit të dytë të nenit 38 “Dispozita kalimtare” me qëllim saktësimin e përkufizimit të të ardhurave bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, si dhe unifikimin e këtij paragrafi me përcaktimet e tjera të bëra në ligjet e fushës.

Flamur Noka – Ndaj po ju them, ju vazhdoni me kokëfortësi, por djersa do të jetë fundi juaj, djersa nuk do të ketë më fuqinë ... mbi ju. Faleminderit!

Blerina Gjylameti - Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e ndryshimeve që përmban ky projektligj do të rregullohen edhe nëpërmjet akteve nënligjore, siç është për shembull edhe rishikimi i udhëzimit për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, i cili nuk ka ndryshuar që nga vitit 2008.

Edmond Spaho – Si ju që jepni fjalën, ashtu edhe ata që marrin fjalën jeni njëlloj, sepse keni të njëjtin qëllim, vjedhjen dhe grabitjen e pasurisë dhe pronës shtetërore nga oligarkët, të drejtuar...

Blerina Gjylameti – Masat e propozuara do të shoqërohen me efekte fiskale, të cilat do të reflektohen në buxhetin e vitit të ardhshëm duke qenë se ndryshimet e propozuara në nenin 28, do të hyjnë në fuqi në 1 janar të 2019.

Në përfundim të fjalës sime dua të vlerësoj faktin se secila nga dispozitat e këtij projektligji është hartuar në shërbim të interesit publik dhe në përputhje të plotë me politikat e shtetit për grumbullimin e të ardhurave të ligjshme, pa harruar edhe krijimin e lehtësira për biznesin prodhues, uljen e barrës fiskale, stimulimin e prodhimit vendas, shtimin e numrit të punonjësve në sektorin vendas, minimizimin e evazionit fiskal dhe në sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike. Për këtë arsye i ftoj kolegët deputetë ta miratojmë në parim atë.

Edmond Spaho – Ju keni frikë dhe vetëm nga frika ju hapet goja, sepse të gjitha këto që bëni janë kundër interesave të qytetarëve shqiptarë.

Blerina Gjylameti - Ndërkohë, kam disa pyetje për zotin ministër.

Së pari, për sa i përket agroturizmit dhe lehtësirave fiskale me 5% për një periudhë 10-vjeçare. Ndërkohë, sipas VKM-së, nr. 22, në pikën 16 është përcaktuar: “Bazuar në vendimmarrjen e komisionit, ministri përgjegjës për turizmin lëshon certifikatën “Subjekt i certifikuar agroturizmi”. Certifikata lëshohet për një periudhë 5-vjeçare”. Ndërkohë kjo VKM nuk ka parashikuar se si procedohet pas kalimit të afatit 5 vjeçar.

Pika 4 e ligjit, objekt shqyrtimi, ka parashikuar se norma e reduktuar e tatimit 5%, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi” deri në dhjetor të vitit 2021. Pra, duket që ka një moskoherencë ndërmjet afatit të vlefshmërisë së certifikatës me afatin e përfitimit të lehtësisë fiskale. Ju lutem të më jepni një shpjegim për sa i përket kësaj pike.

Një element tjetër për të cilin do të doja të kishim një shpjegim nga ju, zoti Ministër, ka të bëjë me pikën 1 të nenit 11, e cila ndryshohet si më poshtë vijon:

“Fitimi i kapitalit i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndertës, truall dhe tokë bujqësore, tatohet me normën 15%.

Në rastet kur kemi një kalim të pronësisë ...

Flamur Noka – Le ta shikojnë qytetarët shqiptarë një bandë të vërtetë hajdutësh në aksion teksa mbrojnë kryehajdutin, i cili po vjedh pasurinë publike të qytetarëve shqiptarë. Shikojini! Nuk ka rast më të mirë për të parë një bandë hajdutësh ...

Blerina Gjylameti – ... Së treti, për sa i përket normës 15% të tatimfitimit për të gjitha lojërat e fatit, rasti i “Lotarisë Kombëtare”, e cila parashikon

Flamur Noka – Pasi e mbushën Shqipërinë me drogë, me krim, mbushën parlamentin me kriminelë, tani mbrojnë paratë e tyre të vëna me trafik droge. Shikoji, qytetarë shqiptarë, një bandë hajdutësh.

Arben Ahmetaj – Për sa i përket ... 22, është një akt dhe një nënakt.

Akti ligjor është ky që zbrit tatimfitimin për agroturizmin nga 15% në 5%. Ndërsa...

Flamur Noka – Akti i fundit që duhet të bëni është të ikni. Nuk ekziston asnjë qeveri në botë që të ketë bërë ligj për të vjedhur me ligj, vetëm ju e keni bërë. Për 5 vjet vodhët gjithçka në këtë vend, aq sa nuk ka ngelur gjë dhe tani doni të bëni edhe ligj për të vjedhur tokat e qytetarëve shqiptarë.

(Arben Ahmetaj nuk dëgjohet kur flet)

.... as skuqeni, as zverdheni, por recitoni këtu. Edhe shfaqja e sotme është tregues që ju jeni në fundin e marrëzisë suaj dhe në fundin e marrëzisë së kësaj qeverie horrash dhe banditësh, sepse ... Kjo arrogancë tregon që ju nuk keni asnjë ndjeshmëri për fatet e vendit dhe fatet e shqiptarëve. Kjo mbledhje që keni organizuar ju është thjesht një pazar për të ndarë llokmat, siç keni bërë për 5 vjet. Si nuk skuqeni dhe as nuk zverdheni? Diskutoni qoftë edhe një herë të vetme për shqiptarët dhe për hallet e tyre dhe jo vetëm si të vidhni. Çdo gjë që vjen këtu është për të modifikuar procedurat e vjedhjes, por si ky ligj që keni bërë ju nuk ka.

Erion Braçe – Ministër, keni më ...

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA